

URDHËR
Nr. 75/1, datë 4.10. 2024

**PËR PËRFUNDIMIN E NGARKIMIT TË PËRKOHSHËM/ZËVENDËSIMIT NË
DETYRË**

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të ligjit 8417/1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të urdhrit nr. 609, datë 2.10.2024, të Kryeministrit “Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve”,

URDHËROJ:

1. Përfundimin e ngarkimit të përkohshëm, nëpërmjet zëvendësimit në detyrën e drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, znj. Elidjana Çelaj, zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Hartimit të Programeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
 2. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Financave, për komunikimin e këtij urdhri, si dhe znj. Elidjana Çelaj dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e tij.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj